

ALB - ENERGY sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE:	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	
PASQYRA E PERFORMANCËS	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5
	6 – 18

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe ortakëve të Shoqërisë Alb-Energy shpk

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të shoqërisë Alb-Energy shpk (më poshtë "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2015, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Alb-Energy shpk më datën 31 dhjetor 2015, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.



5 maj 2016

ALB-ENERGY SH.P.K.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

AKTIVE	Shënime	31 dhjetor 2015
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare		
Llogari të arkëtueshme tregtare	4	250,927,544
Të tjera llogari të arkëtueshme	5	120,036,505
Inventari	6	26,726,375
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	7	7,624,222
Total aktive afatshkurtra	8	1,430,197
		406,744,843
Aktivët afatgjatë		
Aktive afatgjatë materiale		
Aktive afatgjatë jomateriale	9	1,975,068,229
Total aktive afatgjatë		-
Total aktive		1,975,068,229
		2,381,813,072
DETYRIMET		
Detyrime afatshkurtra		
Hua afatshkurtra		
Llogari të pagueshme tregtare	10	133,451,748
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	11	17,735,780
Detyrime tatimore	12	379,680,270
Të tjera detyrime	13	28,976,822
Total detyrime afatshkurtra	14	351,258
		560,195,878
Detyrime afatgjatë		
Hua afatgjatë		
Llogari të pagueshme nga palet e lidhura	15	502,429,166
Total detyrime afatgjatë	16	410,450,214
Totali i detyrimeve		912,879,380
		1,473,075,258
Kapitali		
Kapitali i nënshkruar		
Rezerva rivlerësimi		47,160
Fitime të mbartura		392,187,883
Fitimi i ushtrimit		403,661,098
Total kapitali		112,841,673
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	17	908,737,814
		2,381,813,072

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



ALB-ENERGY SH.P.K.
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe
Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shenime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	312,587,765
Puna e kryer nga njesia ekonomike e kapitalizuar	18	6,742,131
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	247,797
Lënda e parë, materiale dhe shërbime		(37,165,779)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	20	(6,742,131)
2) Të tjera shpenzime	21	(30,423,648)
Shpenzime të personelit		(8,410,408)
1) Paga dhe shpërblime	22	(7,346,745)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(1,063,663)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23	(87,322,707)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(1,000)
Shpenzime financiare		(49,751,014)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	25	(49,751,014)
2) Shpenzime të tjera financiare		-
Fitimi/humbja para tatimit		136,926,785
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(24,085,112)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	26	(24,085,112)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-
Fitimi/humbja e vitit		112,841,673
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:		-
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:		-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		112,841,673

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



ALB-ENERGY SH.P.K.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe


Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Rivlerësimi	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Shuma te perfituara nga ndarja	-	-	-	-	-
Transferim në fitimin e mbartur	47,160	392,187,883	403,661,098	-	795,896,141
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:	47,160	392,187,883	403,661,098	112,841,673	112,841,673
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	47,160	392,187,883	403,661,098	112,841,673	908,737,814

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i Alb - Energy sh.pk më 30 mars 2016 dhe janë firmosur si më poshtë.

Z.Pëllumb Beta
 Administrator



ALB-ENERGY SH.P.K.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative	
Fitim / Humbja e vitit	112,841,673
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:	
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	23,738,393
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	87,330,307
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:	
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(146,762,880)
Rënie/(rritje) në inventarë	(7,624,222)
Ndryshimi në parapagime e shpenzime të shtyra	(1,430,197)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	403,005,737
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	471,098,811
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(2,062,398,536)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(2,062,398,536)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	
Të hyra nga hua afatshkurtra	133,451,748
Të hyra nga hua afatgjata	912,879,380
Flukse monetare perfituara nga ndarja	795,848,981
Kapitali i paguar	47,160
Dividendë të paguar	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	1,842,227,269
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	250,927,544
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	250,927,544

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

"ALB-ENERGY" sh.p.k (Shoqëria) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 14 shkurt 2015 në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Mbi Shoqëritë tregtare".

Shoqëria është krijuar nga ndarja e shoqërisë Euron Energy Group në tre shoqëri të reja, njëra nga të cilat është shoqëria Alb-Energy sh.p.k e cila ka filluar aktivitetin në 1 mars 2015.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 47,160 Lekë (dyzet milionë Lek) dhe zotërohet nga ortakët:

- Kadria sh.p.k 23.66%
- Alb Building sh.p.k 76.34 %

Aktiviteti i shoqërisë është ndërtimi, operimi, administrimi, mirëmbajtja, shfrytëzimi dhe transferimi i hidrocentraleve, si dhe marrja përsipër e detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga kontrata koncesionare. Prodhi dhe tregtimi i energjisë elektrike.

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015. Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2015
Euro/LEK	137.28
USD/LEK	125.79

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.



3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali i nënshkruar

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiarë vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.



3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)**3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale**i. Njohja dhe matja**

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Ndertime dhe Instalime	Vlera e mbetur	5%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.



3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë. Shoqëria i njeh të ardhurat kur prodhon energjinë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.



3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)**3.10. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4. MJETE MONETARE

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015:

Vlerë monetare në Lekë
Arka
Banka

31 dhjetor 2015

368,670

250,558,874

250,927,544**5. LLOGARI TË ARKËTUESHME TREGTARE**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

Klientë

31 dhjetor 2015

120,036,505

120,036,505**6. TË TJERA LLOGARI TË ARKËTUESHME**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

TVSH për t'u marrë

31 dhjetor 2015

26,726,375

26,726,375

ALB-ENERGY SH.P.K.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

7. INVENTARË

Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2015:

Materiale të para
Inventar i imët

31 dhjetor 2015

7,173,747

450,475

7,624,222

8. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2015 detajohet si më poshtë:

Shpenzime të periudhave të ardhshme

31 dhjetor 2015

1,430,197

1,430,197



ALB-ENERGY SH.P.K.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

9. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

<i>Kosto</i>	Ndërtesa	Mjete transporti	Makineri dhe pajisje	Pajisje informatike dhe teknike	Mobilje dhe Orendi	Të tjera	Totali
Gjendja më 1 janar 2014							
Shtesa							
Pakësime	2,098,234,200	295,173	5,757,000	5,240,033	121,475	8,832,042	2,118,479,923
Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,098,234,200	295,173	5,757,000	5,240,033	121,475	8,832,042	2,118,479,923
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2014	56,088,987						56,088,987
Amortizim i transferuar nga ndarja	85,602,251	49,492	551,874	244,643	14,128	860,319	87,322,707
Amortizimi i vitit							
Pakësime							
Gjendja më 31 dhjetor 2015	141,691,238	49,492	551,874	244,643	14,128	860,319	143,411,694
<i>Vlera neto kontabël</i>							
Vlera neto nga ndarja	2,042,145,213	295,173	5,757,000	5,240,033	121,475	8,832,042	2,062,390,936
Gjendja më 31 dhjetor 2015	1,956,542,962	245,681	5,205,126	4,995,390	107,347	7,971,723	1,975,068,229



ALB-ENERGY SH.P.K.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe***10. HUA AFATSHKURTER**

Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë
Overdraft nga Raiffeisen Bank

31 dhjetor 2015

133,260,343

191,405

133,451,748**11. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE**

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

Furnitorë

31 dhjetor 2015

17,735,780

17,735,780**12. LLOGARI TË PAGUESHME NDAJ PALËVE TË LIDHURA**

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

Detyrime ndaj palëve të lidhura - Alb Building

31 dhjetor 2015

379,680,270

379,680,270**13. DETYRIME TATIMORE**

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

TVSH për t'u paguar

Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale

Tatimi mbi fitimin

31 dhjetor 2015

4,931,935

245,833

60,661

23,738,393

28,976,822**14. TË TJERA DETYRIME**

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

Paga për tu paguar

31 dhjetor 2015

351,258

351,258

ALB-ENERGY SH.P.K.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe***15. HUA AFATGJATA**

Hua afatgjata

31 dhjetor 2015

502,429,166

502,429,166**16. HUA NGA PALE TE LIDHURA**

Hua nga palet e lidhura - Alb Building

31 dhjetor 2015

410,450,214

410,450,214**17. KAPITALI**

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 47,160 Lekë (dyzet milion Lek) dhe zotërohet nga ortakët:

- Kadria shpk 23.66%(11,158 Lekë)
- Alb Building sh.p.k 76.34 %(36,002 Lekë)

Rezervat e rivlerësimit janë në vlerën 392,187,883 Lekë.

Fitimet e mbartura më 31 dhjetor 2015 janë në vlerën 403,661,098 Lekë.

18. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

Shitje energji elektrike

Puna e kryer nga njësia ekonomike e kapitalizuar

**Për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2015**

312,587,765

6,742,131

319,329,896**19. TË ARDHURA TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë të ardhura nga komisione si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

Komisione

**Për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2015**

247,797

247,797

20. LËNDË TË PARA DHE MATERIALE TË KONSUMUESHME

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave dhe lëndëve të para që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

Materiale dhe lëndë të para të konsumuara

Për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2015

6,742,131

6,742,131

21. TË TJERA SHPENZIME

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

Për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2015

Tatime dhe taksa të ndryshme

14,586,854

Pjese kembimi

3,767,710

Kosto e punimeve

6,907,440

Blerje energji , ujë , karburant

1,061,448

Shpenzime qiraje

148,000

Shpenzime kancelarie

409,501

Shpenzime për pritje dhe përfaqësim

315,243

Mirëmbajtje dhe riparime

66,733

Shërbime bankare

75,879

Shpenzime transporti

1,465,841

Shpenzime të tjera

1,618,999

30,423,648

22. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

Për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2015

Shpenzime për paga

7,346,745

Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore

1,063,663

8,410,408

23. SHPENZIME ZHVLERËSIMI DHE AMORTIZIMI

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

Për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2015

Shpenzime amortizimi

87,322,707

87,322,707



ALB-ENERGY SH.P.K.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015***Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe***24. SHPENZIME TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT**

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Gjopa dhe dëmshpërblime	1,000
	1,000

25. SHPENZIMET FINANCIARE

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime interesi	49,751,014
	49,751,014

26. TATIMI MBI FITIMIN

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Fitimi para tatimit	136,926,785
Shpenzime të panjohura	23,640,628
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	160,567,413
Tatim fitimi @15%	24,085,112
Fitimi neto	112,841,673

27. PALËT E LIDHURA

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Llogari të pagueshme tregtare Alb Building	-	379,680,270
Hua nga Alb Building	-	410,450,214
	-	790,130,484



28. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

29. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT FINANCIAR

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasdatës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

